



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Sekretaria

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më __.02.2023

MBLEDHJA Nr. 09,
Datë 24.02.2023, ora 11:00
e Bordit të ERE-s

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020 dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të *Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Premte, datë 24.02.2023, ora 11:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 09 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të bordit të ERE-s datë 16.02.2023 dhe datë 20.02.2023
2. Mbi kërkesën e shoqërisë “KESH” sh.a., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga TEC, në Gjirin e Vlorës
3. Mbi kërkesën e shoqërisë “Kurum International” sh.a., për modifikimin e licencës nr. 213, Seria PM13P, miratuar me vendimin nr. 132, datë 06.12.2011 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s dhe transferuar me vendimin nr. 126, datë 28.10.2013, të bordit të komisionerëve të ERE-s tek shoqëria “Kurum Interntional” sh.a. për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-i “Shkopet”
4. Mbi kërkesën e shoqërisë “TPLANI HC” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentrali “Valbona”, në lumin e Valbonës, Bashkia Tropojë, me kapacitet të instaluar 2300 kW
5. Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Natyre Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike
6. Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Energy Market Albania” sh.p.k në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARI
Petrit AHMETI